



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 346/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterave në objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Suharekë.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 25.10.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik LVV dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 23 tetor 2013, në Therandë kanë vërejtur se anëtarë të subjektit politik AAK kanë vendosur poster të kandidatit të tyre në muzeun kulturorë në këtë qytet. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotot nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se anëtarët e subjekti politik AAK kanë bërë vendosjen e posterave në objektet publike PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi nuk shihet dhe nuk vërtetohet se posterat në fjalë janë të vendosura në objektin e muzeut kulturor të qytetit ashtu siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 346/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*